



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo



Komuna e Gjiçanit  
Opština Gnjilane  
Municipal Gjiçan  
Gilan Belediyesi

## DREJTORIA E ARSIMIT

05 nr.061-30702

17.03.2014

Në bazë të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, neni 5 pika c, Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës, neni 8 si dhe Udhëzimit Administrativ, 09/2014, Drejtoria e Arsimit në Gjiçan shpallë :

### K O N K U R S PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

#### **-I- Shkolla fillore :**

##### **1. Shkolla fillore "Ibrahim Uruqi" në Bresalç**

- Një mësimdhënës të ciklit klasor

#### **Kushtet e konkursit :**

**Kualifikimi për mësimdhënës :** kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativit të MASHT-it, Nr.09/2014, në mungesë të kandidatëve të cilët kërkohen sipas normativit në fjalë, komisioni do të bëjë një emërim të përkohshëm, konform nenit 35 paragraf 5 të ligjit për arsimin parauniversitar, nr.04/L-032, nga radha e kandidatëve me kualifikim dhe kushte më të përafërt.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës si dhe nëpër kolegjet private brenda Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto vende të punës, duhen që diplomat e tyre ( gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ të MASHT-it,, nr. 8/2010, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Respektohet neni 16 paragraf 5 të Ligjit për Arsimin e Lartë, nr. 04/L-037, ku thuhet : vetëm bartësit publikë të arsimit të lartë mund të ofrojnë programe studimi që qojnë në kualifikimin e një mësimdhënësi për t'u punësuar në një shkollë.

**Për vendin e punës në fjalë nevojiten këto dokumente:** Diploma mbi përgatitjen profesionale ,kopja e letërnjoftimit, vërtetim mbi përvojën e punës, certifikatën e lëshuar nga sektori gjendjes civile me të cilin dëshmohet vendbanimi i kandidatit, si dhe vërtetimi nga gjykata kompetente se personi nuk është nën hetime. Të gjitha duhen të jenë kopje dhe nuk kthehen.

Paga : caktohet paga bazë.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga shpallja në gazeta zyrtare dhe në mjetet e tjera të informimit .

Për këtë vend të punës, kandidatët do t'i nënshtrohen intervistës me gojë.

Komisioni do të bëjë selektim të aplikacioneve dhe në intervistë ftohen vetëm ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit dhe në pajtim me normativin, 09/2014.

Dokumentet e pakompletuara dhe ato të dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara të dorëzohen pranë Qendrës për Shërbim të Qytetarëve në Gjiçan.

Për vendin dhe kohën e mbajtjes së intervistës, kandidatët do të njoftohen përmes listës-ftuese e cila do të vendoset në tabelat e objektit të Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në objektin pranë Qendrës për Shërbim me Qytetarë, pas mbylljes së konkursit.

**Drejtori  
Nazmi Musa**